Kronikë

Lezhë/ U kap i dehur në timon, 41-vjeçari i drejton pistoletën policisë që mos ta arrestojnë! Vihet në pranga

Një 41-vjeçar është arrestuar nga policia e Lezhës, pasi i drejtoi pistoletën efektivëve të policisë. 41-vjeçari rezultoi i dehur, ndërsa në momentin që e ndaluan efektivët, për t'iu shmangur arrestimit iu drejtoi pistoletën të cilën e kishte me fishek në fole



Arma e sekuestruar

Redaksia
7 Shkurt, 08:54 | **Përditësimi: 7 Shkurt, 14:36**

LEZHË- Policia e Lezhës ka vënë në pranga Luan Zabatën 41-vjeç, pasi gjatë ndalimit nga efektivët për një kontroll, për të shmangur arrestimin e tij u ka nxjerrë pistoletën efektivëve.

Policia ka ndaluar gjatë një kontrolli në Shëngjin, 41-vjeçarin banues në Shkodër, për të cilin ka kërkuar që t'i kryhet testi i alkoolit për shkak të sjelljeve të tij të çuditshme. Në atë moment, ai ka kundërshtuar kryerjen e veprimeve procedurale duke nxjerrë një armë zjarri që mbante me vete dhe ua ka drejtuar punonjësve të Policisë, me qëllim që të largohej dhe të shmangte arrestimin.

LEXO EDHE:
Protestë në Milot për të shpëtuar Urën e Zogut, arkitekti italian: Do të bëjmë projektin e restaurimit

'Ndërhyrja e menjëhershme dhe profesionale e shërbimeve të Policisë, ka bërë të mundur neutralizimin e menjëhershëm të shtetasit L. Z., i cili pas kryerjes së testit të alkoolit, ka rezultuar në gjendje të dehur, në masën 1.395 mg/l. Në cilësinë e provës materiale u sekuestrua arma e zjarrit pistoletë me fishekë në fole, e gatshme për qitje, që mbahej pa leje nga ky shtetas.'- njofton policia.

Luan Zabata u arrestua për veprat penale "Mbajtja pa leje dhe prodhimi i armëve, armëve shpërthyese dhe i municionit", "Kundërshtimi i punonjësit të policisë së rendit publik" dhe "Drejtimi i automjeteve në mënyrë të parregullt".

Materialet procedurale i kaluan Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprime të mëtejshme.

M.Q./Shqiptarja.com

TAG: armembajtje pa leje | luan zabata | Lezhe

Komento

Ndalohet rreptësisht ripublikimi i këtij shkrimi, sipas nenit 80, ligji 35/2016

Sondazhi i ditës:
A është i drejtë vendimi për të shtyrë Komisionin Hetimor për 'McGonigal'?

Po | Jo | Nuk e di

Lajme të tjera



49-vjeçari kanos me armë zjarri pronarin e një lokali në Korçë, arrestohet nga policia
7 Shkurt, 09:29

U zhduk 2 vite e gjysmë më parë, gjendet i pajetë turpi i 24-vjeçari Klevis Lleshi! Dyshohet se u mor peng e më pas u vra e u gropos në Shpërdhet të Kurbinit
6 Shkurt, 15:46

Lezhë/ Nxënësit pa ngrohje në gjimnaz! Kaldaja jashtë funksionit, të rinjtë bëjnë mësim në kushte të vështira: E kemi blerë vetë një rezistencë
Elvis Hila
6 Shkurt, 13:20

Lezhë, rrugët në periferi të qytetit të amortizuara! Kanalizimet nëntokësore pengojnë investimet tek rrugët
Elvis Hila
5 Shkurt, 20:55

Moti i keq/ Anulohet lundrimi i 2 trageteve drejt Barit dhe Vlorë-Brindisi! Linja Durrës-Ankona-Durrës do vazhdojë normalisht
4 Shkurt, 11:15

Ndërtimi e sektori i turizmit në krizë për punëtorë, qytetarët në Lezhë zgjedhin të punojnë në Gjermani: Këtu janë pagat e ulëta, pa sigurime
Elvis Hila
3 Shkurt, 15:30

Familja në Lezhë përjeton momente paniku, një grup personash u hyjnë në shtëpi! Kryefamiljari kthehet nga Mali i Zi: Gruas i kanë thënë se ishin policë
3 Shkurt, 13:12

S'ka dritë jeshile për ish-të burgosurin politik në Lezhë! Ndue Murcaj jeton poshtë urës prej 3 muajsh, institucionet 'ping-pong' për vitet e burgut
Elvis Hila
2 Shkurt, 16:38

Vrasja e rapsodit Kol Murrani dhe Preng Simonit në prill 2020 pasi zbuluan parcelat me kanabis, Apeli lë në fuqi burgun përjetë për Aleksandër Përdodën
1 Shkurt, 14:44

Qarkullonin me pistoletë dhe kokainë në zonën e ish-bllokut, arrestohen 2 persona në Tiranë (EMRAT+ VIDEO)
1 Shkurt, 12:33

Dhjetëra kamionë me inerte kalojnë në zonë të banuar! Bashkia s'mban premtimin, banorët sërish në protestë: Kemi frikë për jetën e fëmijëve
Elvis Hila
1 Shkurt, 11:15

VIDEO/ Aksident në rrugën Lezhë-Rrilë, makina përplaset me shtyllat anësore dhe përmbyset! Përfundon në spital drejtuesja e mjetit
1 Shkurt, 08:54

RAPORTO! Chat live me Shqiptarja.com

© 2011 - 2023 Shqiptarja.com - Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i kesaj faqeje